



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT DHE LEXIMIT

RREGULLORE
PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT KULTUROR “ÇMIMET
KOMBËTARE TË LETËRSISË” PËR VITIN 2025, PËR KUSHTET, MASAT E
SHPËRBLIMIT DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË JURISË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në bazë të Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar, dhe VKM-së Nr. 24, datë 16.01.2019, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit".

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kushtet për vlerësimin e “Çmimeve Kombëtare të Letërsisë” 2025, masën e shpërblimit të fituesit dhe mënyrën e funksionimit të Jurisë.

KREU II
KUSHTET PËR VLERËSIMIN E PROJEKTIT KULTUROR ÇMIMET KOMBËTARE
TË LETËRSISË 2025

Neni 3
Projekti kulturor “Çmimet Kombëtare të Letërsisë” 2025

1. Projekti kulturor i Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, “Çmimet Kombëtare të Letërsisë”, është një ngjarje tradicionale, e përvitshme, nëpërmjet të cilit vlerësohet krijimtaria letrare, studimore dhe përkthimore, të botuara përgjatë një viti kalendarik;
2. Çmimet Kombëtare të Letërsisë nxjerrin në pah vlerat më të spikatura të një viti me synimin për t'i promovuar, përhapur dhe për të orientuar drejt tyre lexuesin;
3. Çmimet Kombëtare të Letërsisë që shpallen në fund të vitit 2026 (ose në fillim të vitit 2027) marrin në konsideratë botimet e vitit 2025;
4. Çmimet Kombëtare të Letërsisë për vitin 2025 janë të ndara në kategori si më poshtë:
 - a. Proza e gjatë
 - b. Proza e shkurtër
 - c. Poezia
 - d. Kritikë, studime letrare, ese
 - e. Letërsia për fëmijë dhe të rinj
 - f. Përkthimi.

Neni 4

Përzgjedhja paraprake e botimeve për vlerësim

1. Çmimet Kombëtare të Letërsisë jepen për botime të realizuara në përputhje me Ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Çmimet Kombëtare të Letërsisë marrin në konsideratë botimet në gjuhën shqipe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e botimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
3. Në Çmimet Kombëtare të Letërsisë përjashtohen ribotimet;
4. Krijimtaria letrare, studimore dhe përkthimore, mes së cilës përzgjidhen veprat dhe autorët për t’u çmuar, duhet të jetë në formë të shtypshkruar;
5. Botimet duhet të kenë ISBN dhe të jenë pjesë e fondit të Bibliotekës Kombëtare;
6. Botimet duhet të jenë vënë në dispozicion të publikut;
7. Lista e librave që merren në shqyrtim për Çmimet Kombëtare të Letërsisë ofrohet nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, mbështetur në kërkesat e botuesve për ISBN gjatë vitit të cilit i referohen çmimet.

KREU III

MËNYRA E EMËRIMIT TË JURISË VLERËSUESE TË ÇMIMEVE KOMBËTARE TË LETËRSISË 2025, PROCEDURA E PUNËS, MËNYRA E VENDIMMARRJES DHE VOTIMI

Neni 5

Emërimi i Jurisë

1. Në kuadër të projektit kulturor, “Çmimet Kombëtare të Letërsisë”, krijohet juria qendrore si një organ vendimmarrës për përzgjedhjen e fituesve;
2. Juria qendrore emërohet nga drejtori i QKLL-së, pas diskutimit me anëtarët e Kolegjiumit, nga një listë prej jo më pak se 10 (dhjetë) propozimesh;
3. Juria vlerësuese qendrore ka në përbërje të saj personalitete të shquara në fushën e letrave, të studimit, kulturës dhe të shkencës;
4. Jurisë qendrore i bashkëngjitet një juri fëmijësh të zgjedhur nga shkolla të ndryshme pas konsultimit me Ministrinë e Arsimit.

Neni 6

Përbërja e Jurisë

1. Juria qendrore përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët nga radhët e veta, me konsensus, zgjedhin Kryetarin;
2. Zgjedhja e kryetarit bëhet në mbledhjen e parë të jurisë;
3. Në mungesë të konsensusit, kryetarin e cakton drejtori i QKLL-së;
4. Kryetari udhëheq mbledhjet e jurisë;

5. Për moscenimin e procesit emrat e jurisë bëhen publikë vetëm në momentin e dorëzimit pranë QKLL të listës së kandidatëve për çmime dhe të fituesve;
6. Njëri prej anëtarëve të jurisë qendrore është përgjegjës edhe për menaxhimin e jurisë së fëmijëve;
7. Juria e fëmijëve ka në përbërje 11 (njëmbëdhjetë) lexues të vegjël nga mosha 8-14 vjeç.

Neni 7

Parimet dhe konflikti i interesit

1. Juria qendrore, gjatë kryerjes së detyrave, udhëhiqet nga parimet e:
 - 1.1 Ligjshmërisë;
 - 1.2 Pavarësisë;
 - 1.3 Përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;
 - 1.4 Drejtësisë dhe paanësisë;
 - 1.5 Profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit të shërbimit;
 - 1.6 Ruajtjes së konfidencialitetit;
 - 1.7 Papranueshmërisë së konfliktit të interesit;
2. Nëse konstatohet se ka apo mund të ketë konflikt interesi të anëtarëve të jurisë, anëtarët e jurisë përjashtohen nga juria dhe anëtarët e përjashtuar duhet të zëvendësohen me anëtarë të rinj;
3. Anëtarët e jurisë kujdesen që të mos i cenojnë imazhin, emrin e mirë, si dhe të drejtat e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.

Neni 8

Mbledhjet e Jurisë

1. Juria bën mbledhjen e saj të parë, të thirrur nga drejtori i QKLL në dt. 22.06.2026, me praninë e të gjithë anëtarëve;
2. Juria mbledhet në vijim, sipas një plani të hartuar prej saj, kurdoherë jo më pak se një herë në muaj, përveç rasteve përjashtimore e thirrur nga Kryetari i saj; Drejtori i QKLL-së ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Jurisë, me kërkesë të këtij të
3. Juria e fëmijëve zhvillon veprimtarinë e saj paralelisht, e mbledhur dhe e drejtuar nga anëtari i jurisë përgjegjës për menaxhimin e kësaj jurie.

Neni 9

Kuorumi i nevojshëm

1. Mbledhjet e jurisë qendrore zhvillohen gjithmonë në prani të Kryetarit dhe, në fazën e parë, janë të vlefshme kur marrin pjesë 50+1 për qind e anëtarëve;
2. Në fazën e zgjedhjes së kandidatëve, prania e jurisë duhet të jetë e plotë;
3. Për çdo mbledhje të jurisë mbahet procesverbal gjithëpërfshirës dhe firmoset nga anëtarët e jurisë. Ky procesverbal ruhet si material arkivor i përhershëm;
4. Në mbledhjet e jurisë së fëmijëve mbahet gjithashtu procesverbal, i cili paraqitet në mbledhjen pasardhëse të jurisë qendrore;
5. Procesverbali mund të mbahet nga njëri prej anëtarëve të jurisë ose nga një përfaqësues i caktuar nga QKLL.

Neni 10

Kriteret e vlerësimit

1. Kriteret e vlerësimit të jurisë për secilën veprë janë si më poshtë:
 - a. Vlera artistike e veprës;
 - b. Origjinaliteti dhe vizioni krijues;
 - c. Përdorimi i gjuhës shqipe, pasuria dhe saktësia;
 - d. Kontributi i veprës në panoramën letrare shqipe;
 - e. Impakti i veprës te lexuesi.
2. Botimi duhet të dallohet për kulturë të lartë botuese: punë të kujdesshme redaktoriale, respektim të normave drejtshkrimore, minimum gabimesh shtypi, etj;
3. Veprat e marra në konsideratë për çmim, duhet të jenë botime me vlera estetike edhe në aspektin pamor.

Neni 11

Mënyra e vlerësimit të jurive

1. Çdo anëtar i jurisë qendrore ka të drejtë të propozojë për kandidim deri në 5 (pesë) vepra për secilën kategori, përjashtuar kategorinë “letërsia për fëmijë dhe të rinj”;
2. Propozimet e secilit anëtar jurie jepen të arsyetura;
3. Bazuar në propozimet e secilit anëtar të jurisë qendrore, zgjidhen kandidatët për çmim me proces votimi;
4. Çdo anëtar i jurisë së fëmijëve, e drejtuar nga anëtari i jurisë qendrore, përgjigjës për menaxhimin e jurisë së fëmijëve, ka të drejtë të propozojë për kandidim deri në 2 (dy) vepra për kategorinë “letërsia për fëmijë dhe të rinj”;
5. Bazuar në propozimet e secilit anëtar të jurisë së fëmijëve, zgjidhen kandidatët e kategorisë “letërsia për fëmijë dhe të rinj”, nga e njëjta juri, me proces votimi;
6. Listat e kandidatëve për çmim zgjidhen me shumicë votash;
7. Numri i kandidatëve për çmim për secilën kategori është 10 (dhjetë);
8. Bazuar mbi 10 (dhjetë) kandidatët për çmim, të secilës kategori, përfshi edhe kategorinë “letërsia për fëmijë dhe të rinj”, zgjidhet fituesi, nga juria qendrore, me proces votimi;
9. Votimi në të gjitha rastet bëhet i fshehtë.

Neni 12

Procedura pas vlerësimit të jurisë

1. 10 (dhjetë) ditë përpara organizimit të ceremonisë së ndarjes së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë, juria i dorëzon QKLL listat me 10 (dhjetë) kandidatët për çmim, për secilën kategori, të paracaktuar në këtë rregullore, si dhe listën e fituesve për secilën kategori;
2. Për fituesit e secilës kategori juria harton dhe dorëzon motivacionet;
3. QKLL bën publike në faqen web dhe rrjetet sociale:
 - a. Brenda 24 orësh jurinë;
 - b. Brenda 48 orësh listat me 10 kandidatët për çmim sipas kategorive.

Neni 13

Shpërblimi i anëtarëve të jurisë

1. Për shërbimin e kryer, pjesëmarrjen në Juri, QKLL-ja lidh kontratë individuale shërbimi me secilin anëtar të jurisë në të cilën përcaktohet objekti i shërbimit, afati i kryerjes së tij, detyrimet e palëve, masa e shpërblimit, mënyra e pagesës, ruajtja e konfidencialitetit dhe deklarimi i mungesës së konfliktit të interesit.
2. Marrëdhënia e krijuar ndërmjet QKLL-së dhe anëtarëve të jurisë nuk përbën marrëdhënie pune, por marrëdhënie shërbimi të përkohshme.
3. Pagesa e shpërblimit kryhet pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe pas dorëzimit të raportit përfundimtar, vendimit të arsyetuar të jurisë, procesverbaleve të mbledhjeve dhe dokumentacionit tjetër të kërkuar nga QKLL-ja.
4. Çdo pagesë kryhet në përputhje me rregullat tatimore financiare dhe buxhetore në fuqi, duke aplikuar ndalesat dhe detyrimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV PËRGJEGJËSITË

Neni 14

Vlera e shpërblimit financiar të fituesve të “Çmimit Kombëtar të Letërsisë”

1. Shpallja e fituesve shoqërohet me shpërblim financiar parashikuar nga fondi buxhetor i Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, për financimin e projekteve dhe veprimtarive kulturore;
2. Fituesit e të gjitha kategorive për Çmimet Kombëtare të Letërsisë do të shpërblehen me 200 000 (dyqind mijë) lekë, përfshirë tatimin në burim.

Neni 15

Forma dhe dizajni i çmimeve

1. Shpallja e fituesve shoqërohet, me një kupë dhe me një certifikatë të nënshkruar nga Drejtori i QKLL-së dhe kryetari i jurisë;
2. Certifikata përmban stemën e Republikës së Shqipërisë, logon e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, logon e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, emrin dhe mbiemrin e fituesit, motivacionin, titullin e veprës, nënshkrimin e drejtorit dhe vulën e QKLL-së;
3. Certifikata shtypet në letër kualitative, në formatin A4.

Neni 16

Ceremonia e dhënies së çmimit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, nëpërmjet Sektorit të Bibliotekës dhe të Leximit dhe Sektorit të Krijimtarisë Letrare dhe Përkthimit, në fund të vitit 2026 (ose në fillim të vitit 2027) organizon ceremoninë e dhënies së “Çmimeve Kombëtare të Letërsisë”;

Neni 17

Promovimi i fituesve

Fituesit e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë bëhen pjesë e veprimtarive të ndryshme promovuese dhe fushatave të leximit që organizon QKLL gjatë vitit në vijim.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga drejtori i Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.